LIGJ
Nr. 83/2018

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT NDËRKOMBËTAR PËR PERSONAT E ZHDUKUR (ICMP)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.11.2018

Shpallur me dekretin nr. 10982, datë 27.11.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT NDËRKOMBËTAR PËR PERSONAT E ZHDUKUR
(të referuara bashkërisht si "Palët" ose individualisht si "Palë")

Me dëshirën për të mbrojtur të drejtat e anëtarëve të familjes të personave të zhdukur, veçanërisht duke siguruar që vendndodhja e të zhdukurve dhe rrethanat e zhdukjes së tyre të hetohen në mënyrë efektive;

duke marrë parasysh traktatet për të drejtat e njeriut në të cilat Shqipëria është palë, përfshirë Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të vitit 1950 dhe Konventën Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë e vitit 2006;

duke dashur të avancojnë përpjekjet për gjetjen e personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste në Shqipëri midis datave 29 nëntor 1944 dhe 2 korrik 1991, si dhe në rrethana të tjera për të cilat Këshilli i Ministrave mund të kërkojë ndihmën e ICMP-së;

Palët bien dakord të vendosin bashkëpunimin si më poshtë:

KAPITULLI I
QËLLIMET DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1
Qëllimi

Kjo Marrëveshje do të përcaktojë bashkëpunimin midis Palëve dhe ushtrimin e funksioneve të ICMP-së, ngritjen e Zyrës së ICMP-së në Shqipëri, statusin e ICMP-së në Shqipëri dhe mënyrën e funksionimit, statusin dhe trajtimin e Komisionerëve, zyrtarëve dhe ekspertëve të ICMP-së.

Neni 2
Përkufizimet

"Shqipëria" nënkupton Republikën e Shqipërisë.

"ICMP" nënkupton Komisionin Ndër-kombëtar për Personat e Zhdukur, të themeluar sipas Marrëveshjes për Statusin dhe Funksionet e Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (15 dhjetor 2014).

"Palët" nënkupton ICMP-në dhe Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

"Konventa e Vjenës" nënkupton Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, të 18 prillit 1961.

"Drejtor i Përgjithshëm" nënkupton Drejtorin e Përgjithshëm të ICMP-së dhe gjatë mungesës së tij ose të saj, çdo zyrtar tjetër i caktuar posaçërisht për të vepruar në emër të tij ose të saj, duke përfshirë edhe Shefin e Zyrës së ICMP-së në Shqipëri Drejtuesit e Departamenteve të ICMP-së nënkupton Drejtorët e Departamenteve të ICMP-së dhe gjatë mungesës së tij ose të saj, çdo zyrtar tjetër të caktuar posaçërisht për të vepruar në emër të tij ose të saj.

"Zyrtarët" ose **"Stafi"** nënkuptojnë personat, të caktuar në çdo mënyrë dhe në çfarëdo niveli të vjetërsisë, duke përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm dhe drejtorët e departamenteve të ICMP-së, të cilët ndërmarrin një ose më shumë funksione të përditshme të ICMP-së dhe që nuk paguhen për orë.

"Ekspert Kontraktues" nënkupton një person që kryen një mision të përkohshëm për ICMP-në të kontraktuar nga ICMP-ja.

"Praktikantë" nënkupton të gjithë ata persona të punësuar nga ICMP-ja mbi baza të përkohshme, pa pagë, të cilët mund ose nuk mund të marrin një pagesë.

"Anëtarë të familjes që përbëjnë pjesë të familjes" nënkupton personat e përcaktuar si të tillë në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike.

"Prona" nënkupton të gjitha pasuritë (qoftë materiale, reale apo intelektuale), asetet dhe fondet që i përkasin ICMP-së ose që mbahen ose administrohen nga ICMP-ja në zbatim të funksioneve të saj.

"Autoritetet përgjegjëse" nënkupton Ministrinë e Brendshme.

"Institucione të tjera të përfshira në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje" nënkupton autoritetet kombëtare, qendrore dhe vendore dhe autoritete të tjera përgjegjëse sipas legjislacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, Prokurorinë e Përgjithshme, Institutin për Mjekësinë Ligjore, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Drejtësisë dhe çdo institucion tjetër, bashkëpunimi i të cilëve do të kërkohet sipas kësaj Marrëveshjeje.

KAPITULLI II

Neni 1
Bashkëpunimi midis palëve

1. Palët do të bashkëpunojnë ngushtë për zbatimin e Marrëveshjes dhe për arritjen e qëllimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Autoritetet përgjegjëse do të mbështesin dhe ndihmojnë ICMP-në, ndër të tjera, duke i siguruar ICMP-së qasje në dokumente dhe arkiva dhe duke vënë në dispozicion ekspertët sipas kërkesës së ICMP-së.

3. Palët bien dakord që të lidhin marrëveshje operative sipas nevojës rast pas rasti nëpërmjet Protokolleve të kësaj Marrëveshjeje. Protokollet do të konsiderohen pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje. Marrëveshjet e hollësishme praktike mund të realizohen me autoritetet përgjegjëse të interesuara, duke iu nënshtruar formaliteteve të tilla, siç janë rënë dakord midis autoritetit dhe ICMP-së.

4. Kjo Marrëveshje do të përcaktojë bashkëpunimin ndërmjet palëve për gjetjen e personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste në Shqipëri për periudhën 19 nëntor 1944–2 korrik 1992, ushtrimin e funksioneve të ICMP-së, ngritjen e zyrës së ICMP-së në Shqipëri, mënyrën e funksionimit dhe trajtimin e Komisionerëve, zyrtarëve dhe ekspertëve të ICMP-së.

Neni 2
Përgjegjësitë e ICMP-së

ICMP-ja do të:

- Ndërmarrë përpjekje për të asistuar autoritetet shqiptare në përpilimin e listës së personave që janë zhdukur dhe anëtarët e familjeve të tyre, duke përdorur Qendrën e Kërkimit *Online* të ICMP-së (OIC) dhe

Sistemin e Menaxhimit të Identifikimit të të Dhënave (IDMS);

- Sigurojë asistencë teknike në lidhje me arkeologjinë dhe antropologjinë mjeko-ligjore;
- Sigurohet që familjet e personave të zhdukur të informohen rregullisht në lidhje me përparimin në gjetjen dhe identifikimin e personave të zhdukur;
- Shpërndajë informacione në lidhje me procesin e kërkimit, rikuperimit dhe identifikimit për publikun, në konsultim me autoritetet shqiptare;
- Vazhdojë të kryejë vlerësime të nevojave për të përcaktuar kërkesat për gërmimin, rikuperimin dhe operacionet identifikuese në lidhje me personat e zhdukur;
- Mbledhë të dhëna *ante-mortem* (para vdekjes) për personat e zhdukur dhe mostrat gjenetike referuese nga anëtarët e familjes në përputhje me politikat e saj të mbrojtjes së të dhënave. ICMP-ja do t'i ofrojë Komisionerit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave, kopjet e Politikave të ICMP-së mbi Përpunimin dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ICMP.POL.ST.04.doc), Politikën mbi Mbajtjen e të Dhënave, Të dhëna dhe prova fizike (ICMP.POL.DG.06.doc), Politikën e ICMP-së mbi Konfidencialitetin (ICMP.POL.DG.05.doc);
- Kryejë testime të ADN-së të mostrave *post-mortem* (pas vdekjes) të pranuara nga institucioni përgjegjës i Shqipërisë dhe të kërkojë që të përputhen profilet e ADN-së të marra prej tyre me mostrat e ADN-së të ofruara nga anëtarët e familjes së të zhdukurve në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit ICMP aktuale në kohën e testimit;
- Komunikojë, në kohën e duhur, rezultatet e gjetjeve të saj me Ministrinë e Brendshme, si institucioni shqiptar kompetent;
- Dërgojë raportet e ADN-së në formatin e raportimit standard të ICMP-së te Ministria e Brendshme si institucioni përgjegjës i Shqipërisë, i cili pas marrjes së tyre, ua dërgon autoriteteve përgjegjëse gjyqësore dhe ekspertëve për kryerjen e identifikimeve ligjore dhe lëshimin e certifikatave të vdekjes dhe mundësimin e varrimit të denjë të mbetjeve mortore/trupave të të zhdukurve.

Neni 3

Përgjegjësitë e autoriteteve shqiptare

Autoritetet shqiptare do të:

- Sigurojnë çdo makineri, pajisje dhe fuqi punëtore të nevojshme për të gërmuar varreza dhe për të ndërmarrë ekzaminime;
- Mundësojnë sigurinë e varrezave para dhe gjatë gërmimeve;
- Marrin masa për të siguruar që mbetjet e rikuperuara do të ruhen në mënyrën e duhur;
- Marrin mostrat *post-mortem* (pas vdekjes) në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit të ICMP-së dhe i dorëzojnë në laboratorët e ICMP-së;
- Respektojnë ligjin vendës në hetimin e rasteve të personave të zhdukur, duke përfshirë gërmimin e mbetjeve mortore dhe identifikimin e personave të gjetur;
- Kryejnë identifikimet përfundimtare, duke përdorur raportet e ADN-së të ICMP-së dhe lëshojnë certifikatat e vdekjes;
- Informojnë familjet e të zhdukurve në lidhje me identifikimet;
- Marrin masat për të shënuar të dhënat përkatëse në regjistrat e duhur.

KAPITULLI III
STATUSI, PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E ICMP-së NË SHQIPËRI

Neni 1

Zyra e ICMP-së

Zyra e ICMP-së do të themelohet në Tiranë, kryeqytetin e Shqipërisë. ICMP-ja do të jetë përgjegjëse financiarisht për ambientet, pajisjet dhe orenditë për përmbushjen efektive të funksioneve të saj.

Neni 2

Personaliteti juridik

ICMP-ja gëzon personalitet të plotë juridik sipas ligjit shqiptar dhe ka zotësi juridike për të kryer funksionet e veta, për të lidhur kontrata, për të blerë dhe shitur prona të luajtshme dhe të paluajtshme dhe për të vendosur

dhe ndjekur procedurat ligjore në funksion të përmbushjes së detyrave të saj.

Neni 3
Logoja dhe përkufizimet

1. ICMP-ja mund të përdorë logon e ICMP-së dhe simbolet e tjera në mjediset e saj dhe në mjetet motorike të ICMP-së.

2. Automjetet motorike të ICMP-së kanë të drejtën e regjistrimit diplomatik dhe statusit përkatës sipas legjislacionit të Shqipërisë.

Neni 4
Imunitetet dhe privilegjet

1. ICMP-ja do të gëzojë imunitetet dhe privilegjet e garantuara për të gjitha misionet diplomatike të akredituara në Shqipëri në përputhje me Konventën e Vjenës. Kuptohet që ICMP do të përjashtohet nga tarifat dhe taksat në përputhje me Konventën e Vjenës.

2. Ambientet e ICMP-së janë të paprekshme.

3. Ambientet duhet të jenë nën kontrollin dhe autoritetin e ICMP-së, siç parashikohet në këtë Marrëveshje.

4. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje dhe në dokumentet e qeverisjes të ICMP-së dhe rregulloreve të ICMP-së dhe të personelit të shpallura në lidhje me kushtet e punësimit të zyrtarëve, në ambiente do të zbatohen ligjet dhe rregulloret e Shqipërisë. ICMP-ja menjëherë do të informojë Shqipërinë për çdo rregullore dhe rregullat ekzistuese dhe do të këshillojë Shqipërinë menjëherë për çdo rregullore dhe rregulla të sapomiratuara.

5. Autoritetet përgjegjëse të vendit pritës kanë të drejtë të hyjnë në ambientet e ICMP-së për të kryer detyrat e tyre vetëm me pëlqimin e Drejtorit të Përgjithshëm. Megjithatë, në rastin e një zjarri ose emergjence të ngjashme, ky pëlqim konsiderohet se është dhënë, nëse masat mbrojtëse janë të nevojshme menjëherë.

6. Dokumentet dhe materialet e arkivave të ICMP-së, duke përfshirë të gjitha aplikacionet kompjuterike dhe dosjet digjitale që i përkasin ose janë në pronësi të saj, janë të pacenueshme.

7. Qeveria shqiptare ndërmerr të gjitha masat për mbrojtjen e ambienteve të ICMP-së nga çdo ndërhyrje ose lëndim, ndalim ose shkelje të dinjitetit të ICMP-së.

Neni 5
Fondet

Për qëllime të ushtrimit të funksioneve të saj, ICMP-ja ka të drejtë të marrë, mbajë, shkëmbejë, transferojë të gjitha fondet, monedhat dhe paratë e gatshme dhe t'i shpërndajë ato lirisht në përputhje me rregullat e vendit pritës nën të njëjtat kushte si për misionet diplomatike.

Neni 6
Siguria sociale

Zyrtarët e ICMP-së, me kusht që të mos jenë shtetas të Shqipërisë, do të përjashtohen nga pagesa e kontributeve të detyrueshme në lidhje me çdo lloj sigurimi shoqëror në Shqipëri.

Neni 7
Drejtori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i zyrës

Gjatë mandatit të tij ose të saj në vendin pritës, Drejtori i Përgjithshëm ose Drejtuesi i Zyrës së ICMP-së do të gëzojë imunitete dhe privilegje që u jepen drejtuesve të zyrave të ngjashme të organizatave ndërkombëtare në Shqipëri.

Neni 8
Imunitetet dhe privilegjet e zyrtarëve të ICMP-së

a) Në kryerjen e funksioneve të tyre zyrtare në territorin e Shqipërisë, personeli ndërkombëtar dhe anëtarët e familjes së tyre, përveç nëse janë shtetas të Shqipërisë apo shtetas të huaj që qëndrojnë përgjithmonë në Shqipëri, gëzojnë të njëjtat privilegje dhe imunitete si të agjentëve diplomatikë apo misioneve diplomatike në Shqipëri, në përputhje me Konventën e Vjenës, përfshirë imunitetet dhe privilegjet e mëposhtme:

b) Imunitet nga juridiksioni penal i vendit pritës në lidhje me të gjitha veprimet e kryera prej tij ose saj në cilësinë e tij ose të saj zyrtare, duke përfshirë fjalët e folura ose të shkruara;

c) Imunitet nga juridiksioni civil dhe administrativ, përveç në lidhje me:

i. një veprim real në lidhje me një ndërtesë private të vendosur në territorin e Shqipërisë, përveç kur është në pronësi të ICMP-së për qëllimet e misionit;

ii. një veprim në lidhje me një trashëgimi në të cilën një anëtar i stafit ndërkombëtar paraqitet si ekzekutues i vullnetit, administratorit, trashëgimtarit, si një individ privat dhe jo në emër të ICMP-së;

iii. për një veprim në lidhje me një profesion të lirë ose aktivitet tregtar të ushtruar nga stafi ndërkombëtar në vendin pritës jashtë funksioneve të tij zyrtare.

d) Paprekshmërinë e të gjitha dokumenteve zyrtare;

e) Paprekshmërinë e bagazhit zyrtar të tij/saj;

f) Paprekshmërinë e bagazhit të tij/saj personal.

Neni 9

Personeli i punësuar në nivel lokal

Personeli i punësuar në nivel vendor, të cilët janë shtetas ose banorë të përhershëm të Shqipërisë, gëzojnë brenda Shtetit pritës vetëm privilegjet, imunitetet dhe pajisjet e mëposhtme në masën e nevojshme për kryerjen e pavarur të funksioneve të tyre:

a) Imunitetin nga procesi ligjor në lidhje me fjalët e folura ose të shkruara dhe të gjitha veprimet e kryera prej tyre në cilësinë e tyre zyrtare për ICMP-në; dhe

b) Paprekshmërinë e të gjitha dokumenteve, dokumenteve, në çfarëdo forme dhe materialeve që lidhen me kryerjen e funksioneve të tyre për ICMP-në.

Neni 10

Eksperti kontraktues

Në kryerjen e funksioneve të tyre zyrtare në territorin e Shqipërisë, ekspertët, përveç nëse ata janë shtetas shqiptarë ose shtetas të huaj që banojnë përgjithmonë në Shqipëri, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a) Imunitet nga juridiksioni për veprimet e kryera prej tyre në kryerjen e funksioneve të tyre, duke përfshirë fjalët e folura ose me shkrim, në detyrë zyrtare;

b) Paprekshmërinë e të gjitha dokumenteve zyrtare, dokumenteve të medias dhe dokumenteve në përputhje me procedurat standarde;

c) Përjashtimin nga kufizimet e emigracionit në përputhje me rregullat e vendit pritës.

Neni 11

Përjashtimi i abuzimeve të imunitetit dhe privilegjeve

1. Privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në këtë Marrëveshje nuk do të bëhen për përfitimin personal të zyrtarëve të ICMP-së që i gëzojnë ato, por për të garantuar ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre.

2. Pa cenuar privilegjet dhe imunitetet e tyre, është detyrë e të gjithë personave që gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në këtë Marrëveshje, teqe të respektojnë ligjet dhe rregulloret e vendit pritës.

Neni 12

Njoftimet

ICMP-ja siguron për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë:

a) Listën dhe numrin e zyrtarëve që nuk janë shtetas të vendit pritës dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët janë pjesë e familjeve të tyre përkatëse, menjëherë ose jo më vonë se tre ditë nga data e mbërritjes së tyre;

b) Përveç kësaj, ICMP-ja do të njoftojë për skadimin e mandatit të cilitdo zyrtar që nuk është shtetas i vendit pritës, i njoftuar në përputhje me paragrafin "a" dhe sipas nevojës, kur një person pushon të jetë një anëtar i familjes së tyre;

c) Zyrtarët joshtetas të vendit pritës, të njoftuar në përputhje me paragrafin e mësipërm, anëtarët e familjeve

të tyre, mbajtës të pasaportave zyrtare, do të pajisen me dokumente identifikimi të lëshuara nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 13

Përgjegjësia e vendit pritës

Shqipëria nuk është përgjegjëse për veprimet apo mosveprimet e kryera nga ICMP-ja dhe personeli i saj brenda territorit të saj.

Neni 14

Çështjet e sigurisë

1. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk përjashton të drejtën e Shqipërisë për të marrë të gjitha masat e duhura për mbrojtjen në interes të sigurisë publike ose për të penguar zbatimin e ligjeve të vendit pritës, të cilat janë të nevojshme për ruajtjen e rendit dhe shëndetit publik.

2. Nëse Shqipëria konkludon se zbatimi i dispozitave të përmendura në paragrafin 1 më sipër është i nevojshëm, sapo rrethanat të lejojnë, ajo do të kontaktojë ICMP-në, me qëllim marrjen e vendimit të përbashkët mbi masat që mund të jenë të nevojshme për mbrojtjen e interesave të ICMP-së.

3. ICMP-ja është e detyruar të bashkëpunojë me autoritetet e vendit pritës për të shmangur çdo dëm të sigurisë publike që rezulton nga ndonjë aktivitet i ICMP-së.

Neni 15

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me anë të konsultimit, negocimit ose mënyrë tjetër pajtimi.

2. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet në përputhje me paragrafin e mësipërm, ai do t'i referohet një arbitri të pavarur të rënë dakord nga palët dhe do të zbatohen Rregullat e Arbitrazhit të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit në Holandë.

Neni 16

Ndryshimet

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve. Ndryshimet duhet të bëhen me shkrim dhe do të hyjnë në fuqi në përputhje me nenin 17 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi kur Këshilli i Ministrave të njoftojë ICMP-në se janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe kur ICMP-ja do t'i konfirmojë Këshillit të Ministrave marrjen e njoftimit.

Neni 18

Përfundimi

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.

Secila palë mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje në çdo kohë, duke i dhënë njoftim me shkrim Palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Ky përfundim do të hyjë në fuqi 6 (gjashtë) muaj pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Pala tjetër.

Nënshkruar në Tiranë, më 18 korrik 2018, në dy origjinalë, në gjuhën shqipe dhe angleze të dyja tekstet njëlloj autentike.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
ZËVENDËSMINISTRI I BRENDSHËM

PËR KOMISIONIN NDËRKOMBËTAR PËR PERSONAT E ZHDUKUR
SHEF I PROGRAMIT PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

COOPERATION AGREEMENT

BETWEEN

THE COUNCIL OF MINISTERS OF THE REPUBLIC OF ALBANIA

AND

THE INTERNATIONAL COMMISSION ON MISSING PERSONS

(Collectively referred to as the "Parties" or individually as the "Party")

DESIRING to protect the rights of family members of persons who went missing, in particular by ensuring that the whereabouts of the missing and the circumstances of their disappearance are investigated effectively;

CONSIDERING the human rights treaties to which Albania is a party, including the European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms of 1950, and the United Nations *International Convention for the Protection of All Persons from Enforced Disappearance* of 2006;

WILLING to advance efforts to locate persons who went missing during the communist period in Albania between 29 November 1944 and 2 July 1991 as well as in other circumstances for which the Council of Ministers may seek the assistance of ICMP;

The Parties agree to establish cooperation as follows:

CHAPTER I
PURPOSES AND DEFINITIONS

ARTICLE 1
PURPOSE

This Agreement shall determine the cooperation between the Parties, and the exercise of ICMP's functions, the establishment of the ICMP Office in Albania, the status of ICMP in Albania, and the mode of operation, status and treatment of ICMP's Commissioners, officials and experts.

ARTICLE 2
DEFINITIONS

ALBANIA means the Republic of Albania.

ICMP means the International Commission on Missing Persons as constituted under the

Agreement on the Status and Functions of the International Commission on Missing Persons (15 December 2014).
PARTIES means ICMP and the Council of Ministers of the Republic of Albania.

VIENNA CONVENTION means the Vienna Convention on Diplomatic Relations of 18 April 1961.

DIRECTOR-GENERAL means the Director-General of ICMP and during his or her absence, any other Official specifically designated to act on his or her behalf, including the Head of Office of ICMP in Albania.

DIRECTORS OF ICMP DEPARTMENTS means the Directors of ICMP Departments and during his or her absence, any other Official specifically designated to act on his or her behalf.

OFFICIALS or STAFF means persons, however denominated and at whatever level of seniority, including the Director-General and the Directors of ICMP Departments, who undertake one or more of ICMP's core day-to-day functions and who are not paid hourly rates.

CONTRACTED EXPERT means a person who conducts a temporary mission for ICMP contracted by ICMP.

INTERNS means all those persons employed by ICMP on a temporary unsalaried basis who may or may not receive a stipend.

FAMILY MEMBER FORMING PART OF THE HOUSEHOLD means persons defined as such in accordance with the Vienna Convention on Diplomatic Relations.

PROPERTY means all property (be it material, real, or intellectual), assets, and funds belonging to ICMP or held or administered by ICMP in furtherance of its functions.

COMPETENT AUTHORITIES means Ministry of Interior (MoI).

OTHER ALBANIAN AUTHORITIES INVOLVED IN THE IMPLEMENTATION OF THIS AGREEMENT: means **national,** central and local administrative unit level competent authorities under the laws, regulations and customs of Albania including the General Directorate of Archives, the General Prosecutor's Office, the Institute for Forensic Medicine, the Ministry of Health and Social Protection, the Ministry of Justice and any other institution the cooperation of which will be required under this agreement.

CHAPTER II

ARTICLE 1
COOPERATION BEWEEN THE PARITES

1. The Parties shall cooperate closely for the implementation of the Agreement and for the achievement of the purpose of this Agreement.

2. The competent authorities will support and assist ICMP, *inter alia*, by providing ICMP with access to documents and archives, and by making available experts upon request by ICMP.

3. The Parties agree to make operational arrangements as needed on a case-by-case basis through Protocols to this Agreement. The Protocols shall constitute an integral part of this Agreement. Detailed practical arrangements may be made with the competent authority concerned subject to such formalities as agreed between the authority and ICMP.

4. This agreement will determine the co-operation between the parties to locate the missing persons during the communist period in Albania during the period 19 November 1944 - 2 July 1992, the exercise of ICMP functions as well as in other circumstances for which the Council of Ministers may seek the assistance of ICMP, establishment of ICMP office in Albania, the mode of operation and the treatment of ICMP commissioners, officials and experts.

ARTICLE 2
RESPONSIBILITIES OF ICMP

ICMP will:

- Undertake efforts to assist the Albanian authorities in compiling a list of missing persons and members of their families, using ICMP's Online Inquiry Center (OIC) and Identification Data Management System (iDMS);

- Provide technical assistance in terms of forensic archeology and anthropology;

- Ensure that families of missing persons are kept regularly informed regarding progress in locating and identifying missing persons;

- Disseminate information regarding the process of search, recovery and identification to the public in consultation with the Albanian authorities;

- Continuously conduct needs assessments to determine the requirements for excavation, recovery and identification operations regarding missing persons;

- Collect ante-mortem data on missing persons, and genetic reference samples from family members in accordance with ICMP's data protection policies. ICMP will provide to the Albanian Commissioner on Protection of Data copies of the ICMP Policy on Personal Data Processing and Protection (ICMP.POL.ST.04.doc), Policy on the Retention of Data, Records and Physical Evidence (ICMP.POL.DG.06.doc) and the ICMP Policy on Confidentiality (ICMP.POL.DG.05.doc);

- Conduct DNA testing of post-mortem samples received from the competent institution of Albania and seek to match DNA profiles obtained from them with DNA samples provided by family members of the missing in accordance with ICMP Standard Operating Procedures current at the time of testing;

- Communicate results of its findings with the MoI as a competent institution of Albania in

a timely manner;

- Submit DNA reports in ICMP's standard reporting format to the MoI as a competent institution of Albania, which shall upon receipt forward these to the competent judicial authorities and experts for purposes of conducting legal identification and to enable the dignified burial of the remains of the missing.

ARTICLE 3
RESPONSIBILITES OF THE ALBANIAN AUTHORITIES

The Albanian authorities will:

- Provide any necessary machinery, equipment and manpower to excavate gravesites and undertake examinations;
- Ensure the security of gravesites before and during excavations;
- Take measures to ensure that recovered remains will be stored appropriately;
- Take post-mortem samples in accordance with ICMP Standard Operating Procedures and submit them to ICMP laboratories;
- Adhere to domestic law in the investigation of missing persons cases, including the excavation of mortal remains and the identification of persons found;
- Perform final identifications using ICMP DNA reports and issue death certificates;
- Inform the families of the missing regarding identifications;
- Take measures to enter the relevant data into the appropriate registers.

CHAPTER III
STATUS, PRIVILEGES AND IMMUNITIES OF ICMP IN ALBANIA

ARTICLE 1
THE OFFICE OF ICMP

The ICMP office will be established in Tirana, the capital of Albania. ICMP will be responsible financially for the facilities, equipment, and furnishings for the effective fulfillment of its functions.

ARTICLE 2
LEGAL PERSONALITY

ICMP enjoys full legal personality under Albanian law and has legal capacity to perform its functions, to make contracts, to purchase and sell movable and immovable property, and to establish and pursue legal proceedings in function of the fulfillment of its tasks.

ARTICLE 3
THE LOGO AND DEFINITIONS

1. ICMP may use the ICMP logo and other symbols on its premises and on ICMP motor vehicles.

2. ICMP motor vehicles have the right of diplomatic registration and the corresponding status under the legislation of Albania.

ARTICLE 4
IMMUNITIES AND PRIVILEGES

1. ICMP shall enjoy the immunities and privileges guaranteed for all diplomatic missions accredited to Albania in accordance with the Vienna Convention. It is understood that ICMP shall be exempt from dues and taxes in line with the Vienna Convention.

2. ICMP premises are inviolable.

3. The premises shall be under the control and authority of ICMP as provided for in this Agreement.

4. Except as otherwise provided in this Agreement and in ICMP governance documents and ICMP's regulations and staff rules promulgated thereunder concerning employment conditions of Officials, the laws and regulations of Albania shall apply on the premises. ICMP shall promptly inform Albania of any such existing regulations and rules and promptly advise Albania of any newly adopted regulations and rules.

5. The competent authorities of the Albania have the right to enter ICMP premises to perform their duties only with the consent of the Director-General. However, in the case of a fire or similar emergency, such consent is deemed to have been given if protective measures are needed instantly.

6. ICMP archive documents and materials, including all computer applications and digital files belonging to or owned by it, are inviolable.

7. The Albanian Government undertakes all measures to protect ICMP premises from any interference or injury, detention or violation of ICMP's dignity.

ARTICLE 5
FUNDS

For purposes of exercising its functions, ICMP has the right to receive, retain, exchange, transfer all funds, currencies, and cash and freely distribute them, in accordance with Albanian legislation under the same conditions as for diplomatic missions.

ARTICLE 6
SOCIAL SECURITY

Officials of ICMP provided they are not citizens of Albania shall be exempt from the payment of compulsory contributions in respect of any kind of social security in Albania.

ARTICLE 7
DIRECTOR-GENERAL AND HEAD OF OFFICE

During his or her term of office in Albania, the Director-General or Head of Office of ICMP shall enjoy immunities and privileges granted to executives of similar offices of international organizations in Albania.

ARTICLE 8
IMMUNITIES AND PRIVILEGES OF OFFICIALS OF ICMP

a) In carrying out their official functions in the territory of Albania, international staff and their family members unless they are nationals of Albania or foreign nationals permanently resident in Albania, enjoy the same privileges and immunities in Albania as those enjoyed by diplomatic agents of diplomatic missions established in Albania in conformity with the Vienna Convention including the following immunities and privileges:

b) Immunity from the Albanian criminal jurisdiction in respect of all acts committed by him/her in his/her official capacity, including words spoken or written;

c) Immunity from civil and administrative jurisdiction, except when it comes to doing so:
   i. For a real action relating to a private building situated in the territory of Albania, except when it is owned by ICMP for the purposes of the mission,
   ii. For an action related to a legacy in which an international staff member appears as executor of the will, administrator, heir, as a private individual and not on behalf of ICMP,
   iii. For an action relating to a free profession or any commercial activity exercised by international staff in Albania outside its official functions;

d) The inviolability of all official documents;

e) The inviolability of his/her official luggage;

f) The inviolability of his/her personal luggage;

ARTICLE 9
RECRUITED STAFF AT LOCAL LEVEL

Staff recruited at the local level who are nationals or permanent residents of Albania shall enjoy within the country only the following privileges, immunities, and facilities to the extent necessary for the independent performance of their functions:

a) immunity from legal process in respect of words spoken or written and all acts performed by them in their official capacity for the ICMP; and
b) inviolability of all papers, documents, in whatever form, and materials relating to the performance of their functions for the ICMP.

ARTICLE 10
CONTRACTED EXPERT

In the performance of their official functions in the territory of Albania, experts, unless they are Albanian citizens or foreign nationals permanently resident in Albania, enjoy the following privileges and immunities:

a) Immunity from jurisdiction for acts committed by them in the performance of their functions, including spoken or written words, in their official duty;

b) The inviolability of all official papers, media records and documents in accordance with standard procedures;

c) Exemption from immigration restrictions in accordance with the rules of Albania.

ARTICLE 11
EXCLUSION OF IMMUNITY AND PRIVILEGES ABUSE

1. The privileges and immunities, provided in this Agreement, shall not be made for the personal benefit of ICMP officials who enjoy them, but in order to guarantee the independent exercise of their functions.

2. Without prejudice to their privileges and immunities, it is the duty of all persons who enjoy the privileges and immunities provided in this agreement, to respect the laws and regulations of Albania.

ARTICLE 12
NOTIFICATIONS

ICMP provides the Ministry for Europe and Foreign Affairs of Albania:

a) The list and the number of officials who are not Albanian citizens and members of their families, who are part of their respective families, immediately or at the latest within three days from the date of their arrival;

b) In addition, ICMP will provide notice of the expiration of the mandate of any official who is not an Albanian citizen, notified in accordance with paragraph (a) and, as may be necessary, that a person ceases to be a member of their family;

c) Officials, not nationals of Albania, notified in accordance with the preceding paragraph, the members of their families, holders of official passports shall be provided with identification documents issued by the Ministry for Europe and Foreign Affairs, in accordance with the Albanian legislation.

ARTICLE 13
RESPONSIBILITY OF THE ALBANIAN PARTY

Albanian Party is not responsible for acts or omissions committed by ICMP and its personnel within its territory.

ARTICLE 14
SECURITY ISSUES

1. Nothing in this Agreement, shall preclude the right of Albania to take all appropriate measures for the protection in the interests of public security or to impede the implementation of Albanian laws, which are necessary for the preservation of public health and order.

2. If Albania concludes that the application of the provisions referred to in paragraph 1 above is necessary, as soon as circumstances will permit, it shall contact ICMP in order to take a joint decision on the measures that may be necessary for the protection of ICMP's interests.

3. ICMP is obliged to cooperate with the Albanian authorities in order to avoid any public security damage resulting from any ICMP activity.

ARTICLE 15
DISPUTE RESOLUTION

1. Any dispute arising out of the interpretation or application of this Agreement shall be settled by consultation, negotiation or other agreed mode of settlement.

2. If the dispute is not settled in accordance with the preceding paragraph, it shall be referred to an independent arbitrator agreed upon by the Parties, and the Arbitration Rules of the Permanent Court of Arbitration in Netherlands shall apply.

ARTICLE 16
AMENDMENTS

This Agreement may be amended by mutual consent of the Parties. Amendments shall be made in writing and shall enter into force in accordance with Article 17 of this Agreement.

ARTICLE 17
ENTRY INTO FORCE

This Agreement shall enter into force upon the Council of Ministers notifying ICMP that all legal requirements for the entry into force of this Agreement have been met where upon ICMP will provide the receipt of notification to the Council of Ministers

ARTICLE 18
CONCLUSION

This agreement will remain into force for an indefinite period.

Each Party may terminate this Agreement at any time by giving written notice to the other Party through diplomatic channels. This conclusion will take effect 6 (six) months after the date of receipt of this notice by the other Party.

Signed in Tirana on 18 July 2018 in two original in English and Albanian language, both texts being equally authentic.

FOR THE COUNCIL OF MINISTERS

DEPUTY MINISTER OF INTERIOR



FOR THE INTERNATIONAL COMMISSION ON MISSING PERSONS

HEAD OF WESTERN BALKANS PROGRAM

